



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 14

Tiranë – E martë, 26 prill 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 217, datë 21.4.2022	Për shpalljen e pozicionit të drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar..... 3
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 218, datë 22.4.2022	Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit..... 5



URDHËR

Nr. 217, datë 21.4.2022

**PËR SHPALLJEN E POZICIONIT TË
DREJTORIT TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.2.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, si dhe urdhrit nr. 68, datë 5.4.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përzgjedhja e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për drejtor të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar do të jetë deri në datën 4.5.2022.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen e zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: www.arsimi.gov.al.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCA NR. 1

**SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.2.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”; si dhe urdhrit nr. 68, datë 5.4.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall procedurat e konkurrimit për vend të lirë, në pozicionin *Drejtor i Përgjithshëm i Arsimit Parauniversitar*.

Kërkesat e përgjithshme, që duhen plotësuar për punësim në pozicionin e mësipërm, janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
4. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
5. Nuk duhet të jetë anëtar në forumet drejtuese të partive politike.

Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Të jetë pajisur me diplomën master shkencor në fushën e mësuesisë;
2. Të ketë mbi 15 vjet përvojë pune në profesion, nga të cilat të paktën 5 vjet si drejtues në institucione arsimore, si dhe në institucionet përgjegjëse për arsimin parauniversitar;
3. Të ketë kategorinë II të kualifikimit si mësues;
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi, certifikata).



DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet, si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip, që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;

2. Letër motivimi;

3. Diplomë master shkencor (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

4. Listë notash e noterizuar për nivelin *Bachelor* dhe master;

5. Certifikatë që vërteton shkallën e kualifikimit;

6. Certifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;

7. Librezë pune (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

8. Fotokopje e kartës së identitetit;

9. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

10. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

11. Vërtetim të gjendjes shëndetësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër duhet të paraqitet, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, brenda datës **4.5.2022**, i cili protokollohet pranë këtij institucioni.

PËRSHKRIMI PËRGJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN, SI MË SIPËR, ËSHTË:

a) Kontrollon dhe garanton përmbushjen e misionit dhe të objektivave të drejtorisë dhe të detyrimeve që ka DPAP-ja dhe DRAP-et;

b) Përfaqëson drejtorinë në marrëdhëniet me të tretët, si dhe autorizon personat që mund të përfaqësojnë drejtorinë në mungesë të tij;

c) Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e drejtorisë, nëpërmjet akteve të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga punonjësit e drejtorisë;

d) Përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për arsimin, për zbatimin e politikave, strategjive dhe programeve në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe përpara Sekretarit të Përgjithshëm për sigurimin e mbarrëvajtjes së administrimit financiar, burimeve njerëzore, veprimtarisë arkivore, dokumentare dhe aktiveve të Drejtorisë Qendrore, në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe rregullatore në fuqi;

e) Merr në shqyrtim dhe adreson rekomandimet apo sugjerimet e brendshme apo të jashtme, me qëllim përmirësimin e praktikave apo të procedurave të zbatuara nga punonjësit e Drejtorisë;

f) Informon në mënyre periodike ministrin përgjegjës për arsimin dhe Sekretarin e Përgjithshëm për problemet e ndryshme, në lidhje me planet e punës apo arritjen e objektivave;

g) Kryen delegimin e detyrave mbi çështjet që i drejtohen për trajtim dhe zgjidhje DPAP-së;

h) Zbaton urdhrat e ministrit dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të MAS-it, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

i) Koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e sektorëve të Drejtorisë Qendrore;

j) Drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e drejtorive rajonale;

k) Raporton te ministri Përgjegjës për Arsimin, mbi verifikimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së DRAP-ve, ZVAP-ve dhe IAP-ve (publike dhe private) me aktet ligjore/nënligjore.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT

Pas datës 9.5.2022, Njësia e Burimeve Njerëzore në MAS do të shpallë në faqen zyrtare të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore, për shkaqet e skualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail-it*).

Kandidatët jofitues kanë të drejtën e ankimit pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të MAS-it, brenda 3 ditëve nga marrja dijeni.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

1. Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Njohuritë mbi ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014–2020.



4. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

5. Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.

6. Ligji nr. 8503, datë 30.6.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

7. Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

8. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.

9. Akte ligjore dhe nënligjore të MAS-it në fushën e arsimit parauniversitar dhe funksionimit të DPAP-së.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Totali i pikëve për vlerësimin e kandidatëve është 100 pikë, i detajuar si më poshtë:

1. Vlerësimi maksimal për intervistën e strukturuar me gojë, që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën: **60 pikë**.

2. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën: **40 pikë**.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURRIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë fituesin në faqen e saj zyrtare (www.arsimi.gov.al). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail-it*)

URDHËR

Nr. 218, datë 22.4.2022

PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NË UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR, MËNYRËN E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE AFATIN E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; dhe të pikës 7, të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin, që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit, do të jetë deri në datën 6.5.2022.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin anëtar të Bordit të Administrimit si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.



5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: www.arsimi.gov.al.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCA NR. 1

NJOFTIM PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, dhe urdhrit nr. 218, datë 22.4.2022, të MAS-it “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, si më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për Bord Administrimi
1.	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë	- 3 anëtarë përfaqësues të MAS-it - 1 anëtar i përkohshëm, deri në përzgjedhjen e përfaqësuesit të studentëve

1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve, që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike,

menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;



- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe të personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

3. Kërkesat e pranimit

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi të largimit nga detyra;
- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;
- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë

kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;

- Të ketë integritet etik dhe profesional;
- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;
- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj;
- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit:

- Kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar IAL-ja ku kandidon;
- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV – *Curriculum Vitae*);
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën *Bachelor*). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të diplomës/certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;
- Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga detyra;
- Formular i vetëdeklarimit i gjendjes gjyqësore;
- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;
- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;
- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;
- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të



Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

5. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën 6.5.2022 në një nga këto mënyra:

a) me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

b) dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni administrohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila vë në dispozicion të komisionit *ad hoc* të ngritur me urdhër ministri, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët.

6. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit kryhet nga një komision *ad hoc* i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatët e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare: www.arsimi.gov.al.

7. Masa e shpërblimit

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në Bordin e Administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

SHTOJCA NR. 1/1

VETËDEKLARIM MBI

MOSANGAZHIMIN NË FUNKSIONE

DREJTUESE PARTIAKE

Deklaruesi:

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrim _____

SHTOJCA NR. 1/2

VETËDEKLARIM MBI KONFLIKTIN E

INTERESIT

Deklaruesi:

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrim _____

SHTOJCA NR. 1/3

VETËDEKLARIM PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar Bordi në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrim _____

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2022